



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:033676 **C. nr. 452/2024**
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05523205

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen juridike kontestimore të paditësit B. (A) B. nga fshati Komuna e Prizrenit, tani me banim në Prizren kundër të paditurit R. (B) K. nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson A.B. avokat nga Prizreni, me objekt kontesti vërtetimin e pronësisë mbi bazën e shitëblerjes, me vlerë të kontestit 2,100.00 euro, jasht seancës gjyqësore, me datë 29 Mars 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

(Në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia)

REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit B. (A) B. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që në që të vërtetohet se paditësi në bazë të shitblerjes së paluajtshmerisë ngastrës kadastrale nr.P-71813068-..... me sipërfaqe prej 1060 m², e cila gjendet në vendin e quajtur ‘‘Buzakillk’’ ZK Prizren, dhe të vërtetohet se paditësi ka të drejtën e kalimit nëpër ngastrën kadastrale 09077-6 në sipërfaqe prej 585 m², e llojit të shfrytëzimit rrugë, në vendin e quajtur ‘‘Buzakillk’’ ZK Prizren, e cila evidentohet në emër të paditurit , të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, si kërkesë e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësi B. (A) B. nga fshati Komuna e Prizrenit, tani me banim në Prizren në rrugën pranë kësaj gjykate me datën 30 Janar 2024, ka parashtruar padi, me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se është pronarë i paluajtshmerive – ngastrave kadastrale nr.P-71813068-..... me sipërfaqe prej 1060 m², dhe P-71813068-..... në sipërfaqe prej 585 m², të cilat gjenden në vendin e quajtur ‘‘Buzakillk’’ ZK Prizren. Tutje ka shtuar se paditësi në vitet e 90-ta, përkatësisht para 30 vite, nga i padituri e kishte blerë paluajtshmerinë ngastrën kadastrale 09077-2, në sipërfaqe prej 1060 m², me çmimin e shit-blerjes me kontrat interne prej 15,000 Marka Gjermane, me at rast paditësi me të paditurin ishin pajtuar që paditësi të ketë të drejtën e kalimit nëpër ngastrën kadastrale 09077-6 në sipërfaqe prej 585 m², e cila lloji përdorimi-shfrytëzimit e ka rrugë e cila gjendet e evidentuar në emër të të paditurit si pronar i saj, me kërkesë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2024:033676

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05523205

I autorizuari i paditësit me parashtrësën e datës 25.03.2024, i ka deklaruar gjykatës se heqë dorë nga kërkesëpadia.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 149 dhe 388, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si në pikën një të këtij dispozitivi të aktgjykimit.

Për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave nga neni 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

C. nr .452/2024, datë 29 Mars 2024

B.profesional
Ilir Sërtollaj

Gjyqtari
Atdhe Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.